

UNIONI FINANCIAR TIRANE

Tirane 30 Maj 2009

Te nderuar zoterinj,

Ne emer te Unioni Financiar Tirane, qe eshte dhe perfaqesuesi I Kompanise Western Union per Shqiperine, Kosoven e Maqedonine dhe si anetar I Global Compact, kam kenaqesine te konfirmoj edhe nje here mbeshtetjen tone per principet e Global Compact lidhur me ceshtjet e:

- te drejtave te njeriut
- te drejtat e lidhura me te punesuarit e punesimin
- te mbrojtjes se mjedisit dhe
- anti- korrupsionit.

Me ane te kesaj deklarate ne shprehim mbeshtetjen tone per zhvillimin e metejshem te ketyre principeve brenda fushes sone te veprimit. Ne zotohemi se do te bejme iniciativen Global Compact dhe principet e saj pjese te strategjise tone, kultures dhe filozofise se punes.

Prezantimi bashkengjitur eshte nje permbledhje e progresit qe ne kemi arritur gjate periudhes se bashkepunimit tone ne lidhje me keto ceshtje te cilat gjithashtu do te vazhdojme t' i ndjekim ne te ardhmen.

Edmond Leka

Drejtor Ekzkektiv

UNIONI FINANCIAR TIRANE

RAPORT PROGRESI

Unioni Financiar Tirane

info@unionifinanciar.al

Tel: +355 4 2250653

Fax: +355 4 22250654

Tirane, Maj 2009

Unioni Financiar Tiranë u themelua në Mars të vitit 1995, duke filluar aktivitetin e saj “të transfertave të shpejta të parave” si përfaqesues i WESTERN UNION FINANCIAL SERVICES Inc., lider global në shërbimet e transfertave të shpejta të parave me një histori më shumë se 150-vjecare. Në 1999 Unioni Financiar Tiranë (UFT) licencohet nga Banka e Shqipërisë si “institucion financiar, jo-banke” dhe është një nga kompanitë e para e cila e ka zgjeruar aktivitetin e saj në Kosovë e Maqedoni dhe Zvicër. Aktiviteti kryesor i kompanisë janë shërbimet e transfertave të parave nepermjet rrjetit të agjencive në franchisen “Western Union”. Klientet kryesorë të kësaj kompanie janë emigrantët që jetojnë dhe punojnë jashtë në Europë dhe në Amerikë të cilët dëshirojnë të ndihmojnë familjet e tyre me anë të dergimit të parave. Unioni Financiar Tirane është kompania lider në fushën e transfertave të parave me mbi 250 agjenci në rreth 100 Qytete, Bashki dhe Komuna në të gjithë vendin. Komisionet e realizuara nga ky aktivitet përbejnë pjesën kryesore të të ardhurave të krijuara nga kompania ndër vite.

Unioni Financiar Tirane, bashkepunon me PNUD tashme që prej vitit 2005 dhe së bashku me Western Union Foundation, ka mbështetur zhvillimin e disa projekteve në kuadrin e ndihmes për zhvillim në zonat në të cilat ajo vepron, duke konsoliduar imazhin e saj si një kompani me një identitet të shfaqur në aspektin e kontributit social për shtresat në nevojë.

Përgjatë vitit të kaluar Unioni Financiar Tirane së bashku me Western Union Foundation ka mbështetur financiarisht Caritasin Shqiptar dhe Fondin Shqiptar Te

UNIONI FINANCIAR TIRANE

Zhvillimit me 30.000 EUR për rindertimin e zonës së Gerdecit si dhe në ndihmë humanitare dhe sociale të të dëmtuarve nga tragjedia e 15 Marsit 2008.

Gjithashtu në Nentor të 2008 – Unioni Financiar Tirane bashkepunon me Western Union Foundation dhe NGO "Kujdes për të gjithë", duke dhuruar 36.800 Euro për t'ju siguruar banorëve të Gracën në Elbasan, furnizimin me ujë. Nga ky furnizues i ri uji përveç banorëve të Gracënit, Qëndres Mjekësore, Shkolles dhe Qendres të Komunitetit, përfiton ujë gjithashtu i gjithë komuniteti përreth.

Në vazhdimësi të rrugës së realizimit të vazhdueshëm të donacioneve në muajin shkurt të vitit 2009 "Unioni Financiar Tiranë" dhe "Union Bank" dhuron 30 pemë gështenja "Bashkisë të Tiranës" për gjelbërimin e Rrugës "Sami Frashëri", duke mbështetur kështu nismën për zgjerimin e hapësirave publike të gjelbëruara në kryeqytet.

Unioni Financiar Tirane duke ruajtur si objektiv kryesor klientin dhe ofrimin e një shërbimi të cilësive superiore, i ka kushtuar rëndësi të vecante burimeve të saj njerezore si në drejtim të kualifikimit dhe motivimit të stafit ashtu edhe në rekrutimin e punonjësve të rinj me eksperiencë pune të mëparshme apo të sapo dale nga shkolla me të dhëna premtuese. Në funksion të shërbimit WU dhe nevojave që agentet e Unionit Financiar Tirane apo UB kanë, në lidhje me trajnimin e operatoreve të rinj, Departamenti i PPP ka trajnuar gjithsej 129 persona gjatë vitit 2008. Këta operatore trajnohen në bazë të një programi të miratuar nga Drejtuesit Ekzekutivë dhe nuk mungojnë rastet që ato janë pjesë edhe e programit të trajnimit periodik të organizuar për operatorët ekzistues. Ky i fundit sigurisht që përfshin gjatë një viti kalendarik një numër më të konsiderueshëm pjesëmarrësish.

Gjithashtu në kuadër të bashkepunimit me Pro Credit Bank, për ofrimin nga kjo Bankë të shërbimit WU në deget e saj, nga Departamenti i Parandalimit të Pastrimit të Parave i kompanisë tone është bërë trajnimi i operatoreve të rinj për të cilët PCB ka bërë kërkesë. Kjo skemë trajnimi ka filluar të funksionojë në Nentor të vitit 2008 dhe deri në fund të këtij viti janë trajnuar gjithsej 9 operatore. Në bashkepunim të ngushtë me Departamentin e Burimeve Njerezore të UFT-se ky projekt trajnimi do të vazhdojë fuqishëm dhe gjatë vitit 2009.

Prioritet gjatë këtyre trajnimeve kanë patur temat mbi problemet e sigurisë në agjenci, mashtrimet në internet, fushatat e fundit promovionale dhe ceshtje të

UNIONI FINANCIAR TIRANE

ndryshme mbi shërbimin WU, me qëllim përmirësimin e standarteve dhe arritjen e rezultateve të kërkuara për ofrimin e këtij shërbimi.

Është në politiken e kompanisë sone që të kryejë në vazhdimësi trajnime operatoreve të agjencive të shërbimit duke i azhurnuar me programe të reja si dhe me procedurat dhe rregullat e nxjerra nga entet mbikqyrese të shërbimeve financiare. Për vitin 2008 janë kryer 12 trajnime në grup me një total prej 207 operatoresh të trajnuar (pjesëmarrës janë edhe administratorë agjensish).

Unioni Financiar Tirane ka patur një rritje të ndjeshme të shpenzimeve për marketing si rezultat i politikës së vazhdueshme të kompanisë për ngritjen e imazhit, për rritjen e cilësisë së teknologjisë së informacionit, telekomunikacionit dhe teknologjisë si dhe për vazhdimin e investimeve për ngritjen dhe zgjerimin e infrastrukturës së kompanisë.

Vlen për tu përmendur edhe kontributi ynë në zhvillimin e sportit shqiptar dhe aktiviteteve sportive duke sjellë rinovimin e kontratës për mbështetjen e ekipit kombëtar të futbollit me Federatën Shqiptare të Futbollit për periudhën 2008-2010.

Ajo çfarë ka finalizuar suksesin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ne ofrojmë, ka qenë përdyshim serioziteti i punës tonë, angazhimi maksimal dhe bashkëpunimi i ngushtë dhe i frytshëm i të gjithë punonjësve të kompanisë dhe dëshira për të arritur ato synime dhe standarte që do përmirësojnë gjithmone imazhin e kësaj kompanie.

Një nga prioritetet tona kryesore është përdyshim respektimi i të drejtave të njeriut në marrëdhëniet brenda dhe jashtë kompanisë dhe mbështetja e vazhdueshme e punonjësve aktualë dhe atyre të punësuar rishtaz me qëllim menjanimin e çdo forme diskriminimi duke u bazuar në politikat sociale të punësimit.